



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Dep.	DPK	Nr. Prot.	03-02/3249/16
Dep.		Prot. No.	
Nr. Itaq.		Data	23.09.2016
Broj stranica	02	Datum	
Nr. pages			
PRISHTINE			

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 23.09.2016, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-2785/16, për zyrtarin e lartë znj. Nazife Krasniqi, Anëtare e Kuvendit të Komunës së Kaçanikut, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e mundshëm të Konfliktit të interesit.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK-03-02-2785/16, që për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë znj. Nazife Krasniqi, Anëtare e Kuvendit të Komunës së Kaçanikut.

Gjatë zhvillimit të procedurës për identifikimin e rasteve të konfliktit të interesit apo mos pajtueshmërisë në ushtrim në funksionit publik është vërejtur se zyrtari i lartë znj. Nazife Krasniqi, Anëtare e Kuvendit të Komunës së Kaçanikut, figuron si pronar dhe person i autorizuar në një biznes privatë e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L- 051, kjo situatë paraqet konflikt të mundshëm interesit dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet që posedon Agjencia.

Pas kësaj shkrese znj. Nazife Krasniqi, ka kontaktuar me zyrtaret e AKK-së dhe është njoftuar me rastin e iniciuar për situatë të mundshëm të Konfliktit të Interesit znj. Nazife Krasniqi, është pajtuar dhe na ka njoftuar se biznesi ku ajo është pronare dhe person i autorizuar ka mbet vetëm i regjistruar dhe nuk zhvillon asnjë aktivitet, por është zotuar se brenda afatit do te sjell dëshmitë qe është larguar nga funksioni i personit të Autorizuar.

Me datën 09.09.2016 nga znj. Nazife Krasniqi, kemi pranuar dokumentin zyrtar të lëshuar nga ARBK-ja, ku dëshmohet se ne Biznesin me nr.80183453 dhe emër SH.P.T “Yllka” znj. Nazife Krasniqi nuk figuron me si person i autorizuar.

Vlerësojmë se pas veprimeve të ndërmarra nga zyrtari i lartë znj. Nazife Krasniqi, Anëtare e Kuvendit të Komunës se Kaçanikut, duke hequr dore nga funksioni i personit te autorizuar ne biznesin privat janë krijuar rrethana të reja dhe është shmangur gjendjen e mundshme e konfliktit të interesit dhe mos pajtueshmërisë ne ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja,

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues)

Hasan Preteni
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

